



This programme is funded
by the European Union



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016 – 2020

Bashkia Shkodër

Viti 2018

Tabela e Përmbajtjes

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020	5
Gjetjet Kryesore	5
Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Shkodër	7
Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018	9
Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.....	9
Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.	15
Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.....	19
Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër	21

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2018.

Gjetjet Kryesore

- Sipas statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për vitin 2018 në Bashkinë Shkodër janë evidentuar 137 raste të dhunës në familje, specifikisht janë paraqitur 81 raste për kërkesë padi për UM; 3 raste për shkelje të këtij urdhëri, 46 raste të veprës penale (neni 130/a). Gjithashtu 1 rast vrasje.
- Në datë 02.02.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi (*Nr.Prot 1506*) me institucionin e Bashkisë Shkodër. Gjithashtu, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër në datë 20.08.2018 ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën “Papa Xhovani XXIII”. Të dyja këto marrëveshje kanë si qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë nëpërmjet referimit të rasteve dhe shkëmbimit të informacionit në funksion të parandalimit të dhunës në familje në Shkodër.
- Sipas informacioneve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën Janar – Dhjetor 2018 janë paraqitur 23 raste për UM dhe 170 raste për UMM me një total prej 193 rastesh urdhra mbrojtje. Ndërkohë që kjo gjykatë ka pranuar 119 raste, ka pushuar gjykimin për 23 dhe ka rrëzuar kërkesat për 51 raste të kërkesës për UM/UMM.
- Bashkia Shkodër për gjithë vitin 2018 ka organizuar 17 aktivitete ndërgjegjësimi në lidhje me dhunën në familje, duke qenë vetë institucioni koordinues. Ndërkohë që në periudhën Mars – Nëntor 2018 kjo bashki ka realizuar një sërë aktivitete të tjera ndërgjegjësuese në lidhje me barazinë gjinore; të drejtat e fëmijëve, për komunitetin Rom dhe të moshuarit.
- 2 janë trajnimet me fokus punën për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe barazinë gjinore të organizuara për stafin nga Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2018, ndërkohë që asnjë trajnim i përbashkët nuk është organizuar për mekanizmin.
- Koordinimi i bashkisë për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij ka qenë pozitive. Sipas burimeve të bashkisë, të gjithë aktorët e përfshirë i janë përgjigjur në kohë nevojës për veprim dhe menaxhim të rasteve.
- Buxheti i bashkisë për dhunën në familje për vitin 2018 ishte 1. 100.000 lekë, ky buxhet përfshin materialet promocionale për aktivitetet e 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore (spot tv; baner dhe fushata); Zbatimin e kartës së barazisë gjinore; aktivitetin ndërgjegjësues për 8 Marsin dhe pagesën e koordinatorit.

- Ndërkohë që programi i strehimit për bonuset nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2018 në Bashkinë Shkodër, ndaj kategoria e grave të dhunuara nuk ka patur përfitues. Ky është një problem që nuk ka lidhje me MKR por Programi i Strehimit Social nuk është aprovuar në Këshillin Bashkiak dhe procesi është pezulluar.
- Gjatë vitit 2018 janë mbajtur vetëm 3 mbledhje të GTN dhe 2 të KD.
- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, 46 raste u strehuan në strehëzën emergjente, 21 gra me 25 fëmijë. Këtyre përfituesve i'u ofruan shërbime ligjore dhe psikologjike falas, strehim falas, veshmbathje, ushqim, ekzaminime mjekësore dhe ilaçe pa pagesë. Gjithashtu, përfituesit u shoqëruan në çdo moment nga stafi i strehëzës.
- Strehëza e emergjencës në Shkodër është shërbimi i vetëm rezidencial I emergjencës në rajonin verior të Shqipërisë, ndaj me rritjen e rasteve të emergjencës, numri i rasteve për t'u strehuar është përtej kapacitetit të strehëzës dhe është e pamundur të priten raste të reja dhe gjithashtu buxhetet janë të kufizuara për të mbuluar nevojat ushqimore.
- Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, shërbimi për trajtimin e dhunuesve është ofruar pranë Zyrës së Këshillimit për Djem dhe Burra (ZDB), degë e organizatës Gruaja tek Gruaja në Shkodër, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike dhe OJF-të që operojnë në këtë Bashki.
- Bashkëpunimi më Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër vazhdon të mbetet i mirë gjatë vitit 2018. Megjithatë, numri i vendimeve mbetet mjaft i ulët në krahasim më numrin e UMM/UM (119) të pranuar nga gjykata për të njëjtën periudhë. Sipas informacioneve nga Zyra për Djem dhe Burra, ky numër i ulët referimi vjen si pasojë e nivelit të ulët të ndërgjegjesimit të gjykatësve për nevojën e përfshirjes së dhunuesve në programe rehabilitimi.
- Institucionet të cilat plotësojnë kërkesat për Urdhër Mbrojtje për viktimat e dhunës në familje nuk janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar mbi shërbimin për rehabilitimin e dhunuesve dhe si rrjedhojë, gjatë plotësimit të kërkesës për UM nuk kërkojnë masën për të urdhëruar rehabilitimin e dhunuesve. Në të njëjtën kohë, viktimat nuk kanë asnjë informacion në lidhje më këtë shërbim.
- Bashkëpunimi me DVP/seksioni antidhunë është shumë i mirë dhe një pikë e fortë, kryesisht në zbatimin e vendimeve të gjykatës për identifikim dhe afrimin e dhunuesve pranë shërbimit të ZDB.
- Gjatë vitit 2018, shoqata Gruaja tek Gruaja ka trajtuar 21 raste të UM dhe ka plotësuar 4 Urdhëra Mbrojtje.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Shkodër

Drejtoria vendore e Policisë Qarku Shkodër ka në përbërjen e saj 4 komisariate: Komisarjati Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, e Vau i Dejës. Të gjitha të dhënat mblidhen e përpunohen në Drejtorinë vendore të Policisë së qarkut Shkodër. Sipas statistikave të këtij institucioni për vitin 2018 në Bashkinë Shkodër janë evidentuar 137 raste të dhunës në familje, specifikisht janë paraqitur 81 raste për kërkesë padi për UM; 3 raste për shkelje të këtij urdhëri, 46 raste të veprës penale (neni 130/a). Gjithashtu 1 rast vrasje.

Për veprat e mësipërme Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër ka arrestuar 23 autorë; ndaluar 2 autorë.

Në datë 02.02.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi (*Nr.Prot 1506*) me institucionin e Bashkisë Shkodër. Gjithashtu, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër në datë 20.08.2018 ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën “Papa Xhovani XXIII”. Të dyja këto marrëveshje kanë si qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë nëpërmjet referimit të rasteve dhe shkëmbimit të informacionit në funksion të parandalimit të dhunës në familje në Shkodër.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë, Shkodër

Dhuna në familje	Bashkia Shkodër	Burra	Gra
Raste te evidentuara	137		121
Vrasje raste	1		
Viktima	1		1
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	81		81
Shkelje Urdhër Mbrojtje	3		
Vepër penale- Neni 130/a	46		
Autorë të arrestuar	23		
Autorë të ndaluar	2		
Autorë të shpallur në kërkim			
Autorë në gjendje të lire			
Autorë të vetvuarë			

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të gjitha rastet e kërkesë padive përcillen në gjykatë ndërsa procedimet penale me kallëzim në Prokurori.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me datë 02.02.2017, ka nënshkruar “*Marrëveshjen Bashkëpunimi për ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të dhunës në marrdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij*”. Kjo marrëveshje është nënshkruar mes palëve: Bashkia Shkodër; Prefektura e Qarkut Shkodër; Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër; Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër; Zyra e Përmbartimit Shkodër; Shërbimi i Provës- Zyra Vendore Shkodër; Mjeku Ligjor Shkodër; Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Shkodër; Spitali Rajonal Shkodër; Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër; Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër; Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër; Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional; Organizata “Gruaja tek Gruaja” Shkodër; “Zyra e Keshillimit për Djem dhe Burra” Shkodër dhe Shoqata “Hapat e Lehtë” Shkodër.

Sipas informacioneve të këtij institucioni, për periudhën Janar – Dhjetor 2018 janë paraqitur 23 raste për UM dhe 170 raste për UMM me një total prej 193 rastesh urdhra mbrojtje. Ndërkohë që kjo gjykatë ka pranuar 119 raste, ka pushuar gjykimin për 23 dhe ka rrëzuar kërkesat për 51 raste të kërkesës për UM/UMM.

Kallzimet penale paraqiten në Polici apo Prokurori; pas fazës së hetimit ato përcillen nga Prokuroria në Gjykatë për : 1) Kalimin e procedimit në gjykim; 2) Pushimin e procedimit penal etj sipas rasteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Referuar sa më sipër nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë përcjellë dhe regjistruar ne Gjykatë gjithsej 122 çështje penale me objekt nenin 130 të Kodit të Procedurës Penale (çështje ne gjykim paraprak dhe themeli). Për këto çështje gjykata ka dhënë vendimet si vijon:

- 37 vendime themeli;
- 35 janë deklaruar fajtorë;
- 1 i pafajshëm dhe për një të gjykuar është vendosur pushimi;
- 56 vendime paraprake (kalim i çështjes për gjykim etj)

Për vitin 2018, janë zgjidhur me vendim gjyqësor 228 martesë. (228 është numri i vendimeve ku gjykata ka vendosur pranimin e padisë për zgjidhjen e martesës).

Numri i Dhunuesve në familje për vitin 2018 është 37 persona.

Ndërkohë që Gjykata e Apelit nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Shkodër apo me organizata të tjera që punojnë kundër dhunës në familje, etj. Sidoqoftë, në Gjykatën e Apelit, janë lëshuar në total 10 raste të lëshimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes për periudhën Janar – Dhjetor 2018.

Sipas informacionit të marrë nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, në periudhën Janar-Dhjetor 2018 pranë ZVSHP-Shkodër janë paraqitur 13 raste me veprën penale të dhunës në familje. Në disa raste (6 raste) ZVSHP-Shkodër ka bashkëpunuar me “Zyra për Djem dhe Burra” (ZDB), Shkodër, pjesë e shërbimeve të ofruara nga “Gruaja tek Gruaja” për ofrimin e shërbimit të këshillimit në lidhje me këto raste. Në raste të tjera institucioni ka bashkëpunuar me shërbimin e Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor.

Grupi teknik ndërdisiplinor pranë bashkisë Shkodër përgjatë vitit 2018 ka trajtuar në 3 mbledhjet e organizuara 3 raste të dhunës në familje. Ndërkohë që po nëpërmjet këtij sektori është bërë e mundur trajtimi me ndihmë ekonomike i 93 grave të dhunuara, me një shumë prej 3000 lekësh në muaj për secilin rast.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Për riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për viktimat e dhunës në familje është hartuar marrëveshja e bashkëpunimit, dhe janë planifikuar aktivitete në zbatim të kësaj marrëveshje. Gjatë vitit 2018 janë realizuar 3 takime të tryezës teknike për rastet e dhunës në familje dhe 2 takime të tryezës së Komitetit Drejtues. Gjithashtu janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat.

Gjatë këtij viti, është përmyllur puna për hartimin dhe përgatitjen e planit të veprimit gjinor si aktiviteti i parë në zbatim të Kartës Evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017. Dokumenti përfundimtar është prezantuar dhe miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, me datë 20.12.2018.

Përgjatë vitit 2018 Bashkia Shkodër ka organizuar 17 aktivitete sensibilizuese dhe buxheti i shpenzuar ishte 42.600 lekë për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Në aktivitetet e organizuara me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informacionit për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje kryesisht janë të rinjtë gjimnazistë. Gjatë vitit 2018 përveç takimeve ndërgjegjësuese, Bashkia e Shkodrës ka realizuar 10 takime konsultative (7 në njësitë administrative përkatësisht në Ana e Malit, Bërdicë, Postribë, Dajç, Velipojë, Rrethina, Gur i Zi dhe 3 në zonën urbane përkatësisht në lagjet nr. 1, 3 dhe 5), ku pjesëmarrëse në këto takime kanë qenë

gra të cilat kanë diskutuar mbi nevojat e tyre në territor. Në total pjesëmarrës në këto aktivite ishin 266 persona.

Gjithashtu janë organizuar 14 aktivitete mbi promovimin e barazisë gjinore, gjithashtu në punën e perdritshme të qendrave komunitare, në takimet me individë, familje dhe grupe.

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e saj është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Bashkia Shkodër ka nënshkruar rreth 23 marrëveshje të cilat janë zbatuar përgjatë vitit 2018, por nuk kanë munguar edhe bashkëpunime të tjera me OSHC-të për të cilat jo detyrimisht është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Kjo bashki ka bashkëpunuar ngushtë përgjatë vitit 2018 me organizatën Gruaja tek Gruaja, Terre Des Hommes Albania, Hapat e Lehtë, UN Women, UNDP, YWCA dhe Albanian Disability Rights Foundation për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Janë realizuar 2 trajnime me fokus punën për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe barazinë gjinore.

1. **11/05/2018** - Jeta Xhabija dhe Lorena Bardeli: *“Promovimi i të drejtave të grave, nga grupet e pafavorizuara, për informim mbi shërbimet e ofruara për gratë e dhunuara dhe për akses në këto shërbime.”*
2. **27/09/2018** - Lorena Bardeli dhe Egrela Kurtabegu: *“Mirëfunksionimi i mekanizmit të referimit të dhunës me bazë gjinore në zbatim të ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (eksperienca dhe sfida).”*

Ndërkohë që gjatë vitit 2018 nuk ka patur trajnime të përbashkëta të mekanizmit.

Në vazhden e traditës së mirë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile Bashkia Shkodër vijon të ketë bashkëpunim shumë të mirë me organizatat ndërkombëtare të tilla si: UNDP DHE UN WOMEN.

Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
5.3.2018	Biblioteka “Marin Barleti”	Dashamirëset e librit	Bashkia Shkodër
6.3.2018	Muzeu I dëshmisë dhe kujtesës	Instalacion #Kalvar	Bashkia Shkodër

6.3.2018	Galleria e Arteve	Ekspozitë piktore “Mozaik”	Bashkia Shkodër
6.3.3018	Qendra Komunitare “Për Familjen”, Nr.4	Aktivitet sensibilizues me komunitetin e lagjes Nr.4 mbi rëndësinë e rolit të gruas në shoqëri	Bashkia Shkodër
7.3.2018	Muzeu Historik “Oso Kuka”	Instalacion	Bashkia Shkodër
8.3.2018	Sheshi para Bashkisë	Panair me punime artizanale	Bashkia Shkodër
8.3.2018	Qendra Komunitare “Për Familjen”, Nr.5	Aktivitet sensibilizues me komunitetin e lagjes Nr.5 mbi fuqizimin socio-ekonomik të grave	Bashkia Shkodër
8.3.2018	Qendra Komunitare “Për Familjen”, Nr.3	Aktivitet sensibilizues me komunitetin e lagjes Nr.3	Bashkia Shkodër
8.3.2018	Holli i Bashkisë Shkodër	Ekspozitë fotografike “Muzat”	Bashkia Shkodër
9.3.2018	Biblioteka “Marin Barleti”	Takim letrar i grave shkrimtare	Bashkia Shkodër
11.2018	Qendra Komunitare “Për Familjen”		
23.11.2018	Bashkia Shkodër	Konferencë për shtyp - <i>Hapja e fushatës 16 ditore të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore.</i>	Bashkia Shkodër/Gruaja tek Gruaja
25.11.2018	Bashkia Shkodër	Forum diskutimi me temë: <i>“Mirëfunksionimi i Mekanizmit të Referimit Kundër Dhunës në Familje</i>	“Gruaja tek Gruaja”/Bashkia Shkodër
25.11.2018	Bizneset e qytetit (dyqane, bare, restorante, etj.)	Bizneset bashkohen në luftën kundër dhunës me bazë me bazë gjinore	Bashkia Shkodër
25.11.2018	Pedonale Shkodër	InfoPoint: <i>“Kërko Ndhmë!”</i>	“Gruaja tek Gruaja”- “Zyra për Djem dhe Burra”
25.11.2018	Sheshi “Luigj Gurakuqi”	Instalacion në përkujtim të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje.	“Gruaja tek Gruaja”- “Zyra për Djem dhe Burra”
26.11.2018	Shkolla e Mesme “Jordan Misja”	Orë ndërgjegjësuese dedikuar dhunës në familje.	Bashkia Shkodër
26.11.2018	Shkolla e Mesme “Oblikë”	Orë mësimore dedikuar dhunës në familje.	“Gruaja tek Gruaja”

26.11.2018	Pedonale Shkodër	Info Point: #MëDëgjoEdheMua	“Gruaja tek Gruaja”
26.11.2018	Shkolla 9-vjecare Rragam	Orë ndërgjegjësuese dedikuar dhunës në familje.	Bashkia Shkodër
26.11.2018	Shkolla “Haxhi Sheh Shamia	Workshop me temë: “Parandalimi i bullizmit në shkollë. Cfarë ndodh nëse... ..!”	“Zyra për Djem dhe Burra”- Shkolla “Haxhi Sheh Shamia”
26.11.2018	Qendra e gruas “Hapat e Lehtë”	Ekspozitë fotografike	Qendra e gruas “Hapat e Lehtë”
27.11.2018	Qendra Shëndetësore Dajç	Takim informues me temë: <i>Pse duhet të shqetësohem nga pabarazia gjinore?!</i>	“Gruaja tek Gruaja” Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Shkodër
27.11.2018	Zyra për Djem dhe Burra	Workshop me temë: <i>Përfshirja dhe angazhimi i djemve; kusht për promovimin e barazisë gjinore.</i>	“Zyra Për Djem dhe Burra”
03.12.2018	Qendra Komunitare Për Familjen Nr.4	Workshop me temë: <i>Të drejtat pronësore të grave në këndvështrimin gjinor.</i>	“Gruaja tek Gruaja” Bashkia Shkodër
03.12.2018	Ish-Kinema Verore	PhotoShoot-ing Day: “EdheÇështjaIME”	“Gruaja tek Gruaja” “Zyra për Djem dhe Burra”
04.12.2018	Njësia Administrative Temal Qytet Shkodër	Takim informues me temë: Nëse jam viktimë e dhunës, kujt t’i drejtohem? TRIO MARCH: #TëPërgjegjshëmSëbashku	Drejtoria e Shërbimeve Sociale-Bashkia Vau Dejës “Gruaja tek Gruaja”- “Klubi Social Rinor
05.12.2018	Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi”	Forum Studentor me temë: <i>Burrat, pjesë e problemit apo zgjidhjes?!</i>	“Gruaja tek Gruaja”- “Zyra për Djem dhe Burra”

06.12.2018	Qendra Shëndetësore Shkodër	Takim informues me temë: <i>Ndryshimet e reja në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Cfarë duhet të dimë?</i>	“Gruaja tek Gruaja” Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Shkodër
06.12.2018	Zyra e Kryetares së Bashkisë Shkodër	Mbledhje e Komitetit Drejtues të Sistemit të referimit	Bashkia Shkodër
06.12.2018	Bashkia Shkodër	Shpërndarje e mesazheve ndërgjegjësuese për punonjësit meshkuj të Bashkisë Shkodër	Qendra e gruas “Hapat e Lehtë”
06.12.2018	Qendra komunitare “Për familjen”, Nr.5	Takim ndërgjegjësues dhe informues me komunitetin mbi çështjet e dhunës me bazë gjinore	Bashkia Shkodër
07.12.2018	Biblioteka “Marin Barleti”	Arti flet “Më dëgjo edhe mua”	Bashkia Shkodër
07.12.2018	Qendra Rinore “ARKA” Njësia Administrative Vig-Mnel	Takim në Arka Social Coffee Rezultati? $1/1$, $1/X$, $1/2$, $X/1$, X/X , $X/2$, $2/1$, $2/X$	“Gruaja tek Gruaja”, Qendra Rinore “ARKA” “Gruaja tek Gruaja”/ “Zyra Për Djem dhe Burra”
11.12.2018	Lagjet e qytetit / Njësitë Administrative	Vizita në familje “Derë më derë” për gratë me aftësi ndryshe dhe shpërndarje e materialeve ndihmëse për ta	Bashkia Shkodër ADRF Bashkia Shkodër
11.12.2018	Projekti Shpresa	Vizitë në shtëpi familje	ADRF
13.12.2018	Qendra Rinore “Atelie”	Ekspozitë fotografike ”Burrat dinë me dasht”- <i>Cikli IV</i>	Zyra per djem dhe Burra, Gruaja tek Gruaja, Bashkia Shkodër “Gruaja tek Gruaja”

	Qendra rinore "Arka"	Fundraising <i>MeDegjoEdheMua</i>	Concert:	
--	-------------------------	--------------------------------------	----------	--

Në kuadër të fushatës së përvitshme të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, organizata "Gruaja tek Gruaja" në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe anëtarë të Mekanizmit të Referimit kundër dhunës me bazë gjinore hartuan një kalendar të përbashkët aktivitetesh ndërgjegjësuere i cili u implementua në periudhën 25 Nëntor - 10 Dhjetor. Nën moton *#MeDegjoEdheMUA*, 16 ditët e Aktivizmit u pasuan nga një sërë nismash dhe aktivitetesh të ndryshme me anë të të cilave u evidentua rëndësia e bashkëpunimit me aktorët lokal përgjegjës për implementimin e ligjit të dhunës në familje si dhe veprimet e koordinuara të marra në këtë kontekst duke synuar ndërgjegjësimin e komunitetit.

Aktivitetet u përqendruan në angazhimin e komunitetit dhe ndikimin në nivel lokal duke rritur ndërgjegjësimin në shkolla, universitete, rrugë etj. Gjatë 16 ditëve "Gruaja tek Gruaja" së bashku me aktorët e Mekanizmit të Referimit, kanë realizuar 21 aktivitete dhe fushata ka angazhuar mbi 800 individë në zonat urbane dhe në zonat rurale. "Gruaja tek Gruaja" ka qenë e pranishme për 250 minuta në transmetimet televizive lokale. Krahas kësaj ka patur më shumë se 1000 klikime në kanalet e komunikimit ku dhe nga është përcjellë fushata. Portokallia ishte ngjyra zyrtare e fushatës (fushata zyrtare e OKB-së) që shoqëroi aktivitetet e këtyre ditëve dhe që simbolizon një të ardhme të ndritshme pa dhunë kundër grave dhe vajzave.

Në vijim edhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Shkodër ka realizuar disa aktivitete të ndryshme përgjatë vitit 2018 në kuadër të planit strategjik:

" Stop dhunës" nga shkollat e DAR Shkodër:

1. Me dt 20 Nëntor në të gjitha shkollat e DAR Shkodër ora e pare mësimore i është dedikuar bisedave ndërgjegjësuere mbi të drejtat e fëmijëve. (nga mësuesi lëndës)
2. Gjate muajit nëntor nga psikologu i shkollës janë realizuar projekte me qeverinë e nxënësve dhe grupin në ndihmë të psikologut mbi çështjet e dhunës (Bullizmi, dhuna në shkollë dhe familje).
3. Gjatë muajit nëntor janë realizuar ekspozita (Piktura, postera, sllogane, zarfe sensibilizuese) mbi fenomenin e dhunës.
4. Gjatë muajit nëntor janë realizuar kualifikime të brendëshme me stafin pedagogjik (në disa shkolla) "identifikimi i hershem i nxënësve në rrezik".

Gjithashtu, Drejtoria e Shëndetit Publik, Shkodër ka realizuar tre aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese përgjatë vitit 2018:

27.11.2018 Qendra Shëndetësore Dajç/sesion informues mbi dhunën në familje, takim me komunitetin gra dhe vajza dhe QSH me pjesëmarrjen e 27 personave.

- 5.12.2018** Qendra Shëndetësore Bushat/sesion informues mbi dhunën në familje, takim me komunitetin gra dhe vajza dhe QSH me pjesëmarrjen e 21 personave.
- 6.12.2018** Qendra Shëndetësore Shkodër/sesion infomues mbi dhunën në familje, takim me komunitetin gra dhe vajza dhe QSH me pjesëmarrjen e 19 personave.

Duke qenë se Objektivi 3.1 i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta edhe Bashkia e Shkodrës është e hapur ndaj bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile si edhe atyre me bazë fetare. Në vazhden e bashkëpunimit shumë të mirë me organizatën “Shpresë për Botën“ Bashkia e Shkodrës mbështet me pako ushqimore familjet me vështirësi socio-ekonomike, familje këto vulnerabël dhe të predispozuar për tu prekuar edhe nga dhuna në familje.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Marreveshja e nënshkruar në vitin 2017 nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës për rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër edhe përgjatë vitit 2018 ka qenë rezultative.

Koordinimi i bashkisë për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij ka qenë pozitive. Sipas burimeve të bashkisë, të gjithë aktorët e përfshirë i janë përgjigjur në kohë nevojës për veprim dhe menaxhim të rasteve.

Koordinatorë Vendore kundër Dhunës me Bazë Gjinore është Znj. Jeta Xhabija. Sipas të dhënave të përftuara nga bashkia znj. Xhabija është Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit Strategjik, standarteve dhe monitorimit për shërbimet sociale dhe shëndetin publik, por kryen edhe detyrat e Koordinatorës Vendore.

Koordinatorja vendore ka marrë pjesë në disa trajnime mbi dhunën në familje dhe çështjet gjinore, duke përfshirë këtu edhe dy trajnime me fokus punën për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe barazinë gjinore specialiste për strategjinë e zhvillimit

Sipas informacioneve të përftuara nga Bashkia Shkodër, buxheti për dhunën në familje për vitin 2018 ishte 1.100.000 lekë të reja. ky buxhet përfshin materialet promocionale për aktivitetet e 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore (spot tv; baner dhe fushata); Zbatimin e kartës së barazisë gjinore; aktivitetin ndërgjegjësues për 8 Marsin dhe pagesën e koordinatorit.

Fond i planifikuar në buxhetin e bashkisë, në programin buxhetor P10 për: Strehimi dhe Shërbimet Sociale për gratë, viktimat e dhunës në familje, shërbimet e kujdesit social, ndihma ekonomike në raport me buxhetin e Bashkisë Shkodër për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale është 88%.

Ndërkohë që programi i strehimit për bonuset nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2018 në Bashkinë Shkodër, ndaj kategoria e grave të dhunuara nuk ka patur përfitues. Ky është një problem që nuk ka lidhje me MKR por Programi i Strehimit Social nuk është aprovuar në Këshillin Bashkiak dhe procesi është pezulluar.

Sipas informacionit të përcjellë nga Bashkia Shkodër, bashkëpunimi i kësaj bashkie me Drejtorinë e Policisë, Zyrën e Punësimit, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Shërbimin Social ka qenë shumë i mirë, si aktorë të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të GTN-së për vitin 2018 në Bashkinë Shkodër

Viti	Mbledhjet e GTN
6.9.2018 30.10.2018 8.11.2019	<p>Gjatë vitit 2018 janë organizuar 3 takime të tryezës teknike për rastet e dhunës në familje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për rastin e e një zonje për vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme në interesin më të lartë të të mbijetuarve të dhunës në familje; zonjës dhe fëmijëve të saj. • për rastin e një zonje për vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme në interesin më të lartë të të mbijetuarve të dhunës në familje; zonjës dhe fëmijëve të saj. • Për diskutimin e detyrave dhe përgjegjësisve të secilit aktorë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit për ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij.

Burimi: Bashkia Shkodër

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të KD-së për vitin 2018 në Bashkinë Shkodër

Viti	Mbledhjet e KD
------	----------------

30.3.2018 4.12.2018	Gjatë vitit 2018 janë organizuar 2 takime të Komitetit Drejtues të mekanizmit të bashkërendimit të punës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, të mbajtura në ambjentet e Bashkisë Shkodër gjatë së cilave është diskutuar për identifikimin e problemeve për dhunën në familje, koordinimin e punës në referimin, menaxhimin dhe trajtimin e rasteve, personat e kontaktit, përfaqësues të institucioneve , si dhe konsolidimi dhe vazhdimësia e mekanizmit referues për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, koordinimi i mbledhjeve të grupit teknik ndërsektorial, mbledhja e të dhënave statistikore të standartizura mbi dhunën në familje.
------------------------	--

Burimi: Bashkia Shkodër

Tabela 5. Këshilli Drejtues Bashkia Shkodër viti 2018

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Jeta Xhabija
Drejtoria e Policisë	Dede Gazulli
Gjykata e RrethitGjyqësor	Blenda Behri
Prokuroria e Rrethit	
Drejtoria Arsimore Rajonale	Kadri Ymeraj
Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik	Lindita Haxhija
Zyra e Përmbartimit	
Prefektura	Felek Kasemi
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit	Rozafa Zmijani
Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Meri Markici
Hapat e Lehtë	Denada Shpuza
Gruaja te Gruaja	Majlinda Angoni
Shërbimi I Provës	Frida Dashi
Drejtoria e Shërbimit Social	Valbona Tula
Zyra për djem dhe burra	Endrit Uligaj
Komisariati i Policisë Shkodër	Vasil Cela

Burimi: Bashkia Shkodër

Tabela 6. GTN-ja e Bashkisë Shkodër viti 2018

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Jeta Xhabija
Drejtoria e Policisë	Dede Gazulli
Gjykata e RrethitGjyqësor	Blenda Behri
Prokuroria e Rrethit	
DrejtoriaArsimoreRajonale	Elisa Lacej

Drejtoria e Shëndetit Publik	Kilda Cela
Zyra e Përmbartimit	Enderson Memcaj
Prefektura	Felek Kasemi
Kryetarët e Njësive Administrative	
Zyra e Punësimit	Fatbardha Gradeci
Organizata Jo qeveritare	
Strehëzat për viktimat e dhunës	
Komunitetefetare	
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	
Hapat e Lehtë	Luljeta Alibali
Gruaja tek Gruaja	Sindi Kola/Atila Uligaj
Shërbimi I Provës	Nandi Samarxhi
Drejtoria e Shërbimit Social	Orjeta Halluni
Zyra për djem dhe burra	Endrit Uligaj
Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Nora Asllani

Burimi: Bashkia Shkodër

Përgjatë vitit 2018 në Bashkinë e Shkodrës janë raportuar gjithsej 73 Urdhëra Mbrojtje, të cilët janë rregjistruar në sistemin databazë dhe janë ndjekur e zbatuar sipas detyrave funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe vendimeve të Gjykatës.

Gjatë vitit 2018, shoqata Gruaja tek Gruaja ka trajtuar 21 raste të UM dhe ka plotësuar 4 Urdhëra Mbrojtje.

Strehëza e Emergjencës në Shkodër është një hapësirë e përkohshme dhe e sigurtë që strehon gratë dhe fëmijët që përjetojnë situata të dhunës në familje, vajzat që ikin nga një situatë e dhunshme e partnerit intim ose që rikthehen nga sulmet seksuale deri sa të gjejnë strehim afatgjatë. Kjo qendër është një nga shërbimet më të rëndësishme sociale në të gjithë Shqipërinë, duke ofruar 48 orë strehim të sigurt dhe të besueshëm për gratë, vajzat dhe fëmijët viktime të abuzimit të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të situatave të dhunshme.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, 46 raste u strehuan në strehëzën emergjente, 21 gra me 25 fëmijë. Këtyre përfituesve i'u ofruan shërbime falas ligjore dhe psikologjike, strehim falas, veshmbathje, ushqim, ekzaminime mjekësore dhe ilaçe pa pagesë. Gjithashtu, përfituesit u shoqëruan në çdo moment nga stafi i strehëzës.

Rritja e numrit të grave të dhunuara përbën një problem jo vetëm në aspektin social por edhe në atë logjistik për t'ju ardhur në ndihmë. Strehëza e emergjencës në Shkodër është shërbimi i vetëm rezidencial emergjent në rajonin verior të Shqipërisë.

Situata e grave dhe vajzave që vuajnë nga dhuna në familje është shumë e vështirë, duke përfshirë këtu edhe vështirësitë ekonomike dhe keqkuptimin social dhe papranueshmërinë e familjeve të këtyre target grupeve. Kjo i bën shumë gra, të cilat e lënë burrin e tyre abuziv, të mbeten pa ndihmë dhe pa shtëpi. Megjithëse disa prej këtyre grave nuk mund të jenë në një situatë kërcënuese për jetën, ato ende kanë nevojë për strehim emergjent derisa të gjejnë një zgjidhje për jetën e tyre dhe fëmijët e tyre.

Me rritjen e rasteve të emergjencës, numri i rasteve për t'u strehuar është përtej kapacitetit të strehëzës dhe është e pamundur të priten raste të reja.

Gjithashtu, informacioni i marrë nga kjo strehëz, specifikon se buxhetet janë të kufizuara për të mbuluar nevojat ushqimore, dhe ky është një prej problemeve serioze që kërkojnë zgjidhje alternative të menjëhershme.

21 janë përfitueset që kanë marrë shërbimet e nevojshme pranë strehëzës “Gruaja tek Gruaja”, Shkodër:¹

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, shërbimi për trajtimin e dhunuesve është ofruar pranë Zyrës së Këshillimit për Djem dhe Burra (ZDB), degë e organizatës Gruaja tek Gruaja në Shkodër, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike dhe OJF-të që operojnë në këtë Bashki. ZDB është pjesë e Mekanizmit të referimit kundër dhunës në familje në Bashkinë e Shkodrës, Bashkinë e Malësisë së Madhe dhe Vau Dejës, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me Gjykatën e rrethir Gjyqësor të Shkodrës, Drejtorinë e Policisë, Shërbimin e Provës, Dhomën e Avokatisë, Shërbimin Social Shtetëror si dhe organizatat e tjera që angazhohen në çështjet e dhunës në familje.

Shërbimi për trajtimin e dhunuesve pranë ZDB, përmban këshillim individual ballë për ballë si dhe këshillim individual në telefon,

Kryesisht, klientët referohen pranë shërbimit nga institucionet partnere: Gjykatat, Policia, Shërbimi i Provës etj. Klientët paraqiten në çdo rast pranë zyrave të qendrës së shërbimit të shoqëruar, vetëm në takimin e parë, nga një punonjëse i institucionit referues.

Praktikat e ndërhyrjes bazohen në besimin që dhuna është një sjellje e mësuar dhe burrat që kryejnë akte dhune, e kanë mundësinë dhe aftësinë për të modifikuar dhe ndryshuar sjelljet e tyre te

¹ Burimi: Strehëza “Gruaja te Gruaja” Shkodër

dhunshme. Gjatë procesit të këshillimit fokusi vihet mbi temën e dhunës, marrëdhënien që klienti ka me dhunën, besimet, bindjet, traditat, modelet, normat e klientit dhe një peshë të madhe zë diskutimi mbi aktet e dhunës së kryer nga klienti dhe pasojat e kësaj dhune tek viktimat e tij.

Këshilluesi e shoqëron klientin e tij drejt kuptimit dhe pranimin të përgjegjësive dhe pasojave të veprimeve të tij të dhunshme dhe gjetjes së motivimit për të ndryshuar sjellje. Shërbimi i këshillimit jepet nga këshillues profesionistë të trajnuar dhe çertifikuar për ofrimin e këtij shërbimi edhe në ambientet e ZDB-s te konceptuar enkas për këtë lloj shërbimi. Nje cikël zgjat minimalisht 16 - 24 seanca. Seanca zgjat 50-55 minuta dhe çdo klient ndjek 1 seancë në javë. Shërbimi ofrohet falas për të gjithë klientët. Klientët që marrin këtë shërbim duhet ti përmbahen kushteve dhe rregullave të caktuara, më cilat njihen paraprakisht.

Gjatë vitit 2018, pranë ZDB janë referuar 29 burra me të cilët janë realizuar 191 seanca këshillimi në total. Të ndarë sipas institucioneve referuese, 3 persona janë referuar nga Dhoma e Avokatisë; 4 nga policia; 3 nga gjykata; 3 nga OJF; 6 persona dhunues janë referuar nga Shërbimi I Provës; 6 raste janë referuar nga shkolla; 1 person është referuar nga individë dhe 3 të tjerë janë paraqitur vullnetarisht.

Nga 29 rastet në total, 5 klientë e kanë ndërprerë procesin e këshillimit në fazë të hershme ose kanë refuzuar të fillojnë procesin, raste për të cilat ZDB ka raportuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër.

Numri mesatar i seancave për klient është 6.6 seanca, që mbetet akoma i ulët në krahasim me numrin e seancave të nevojitura për të plotësuar programin e plotë të këshillimit. Problematik mbetet fakti që institucionet referuese nuk përcaktojnë në vendim numrin e seancave që dhunuesi duhet të ndjekë në mënyrë të detyrueshme, për të plotësuar programin. Për këtë arsye, klientët kanë tendencën të ndërpresin programin në fazat e para të trajtimit. Problematikë tjetër në frekuentimin e programit mbetet raportimi në gjykatë. Edhe pse institucioni zbatues i programit të rehabilitimit për dhunuesit, raporton periodikisht pranë gjykatës mbi frekuentimin apo mosfrekuentimin e programit nga dhunuesi sipas UM përkatëse, bazuar në Ligjin 9669 (I rrdyshuar), asnjë veprim nuk ndërmerret nga institucionet përgjegjëse për ndjekjen e çështjes.

Bashkëpunimi më Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër vazhdon të mbetet i mire gjatë vitit 2018. Megjithatë, numri i vendimeve mbetet mjaft i ulët në krahasim më numrin e UMM/UM (119) të pranuar nga gjykata për të njëjtën periudhë, Janar – Dhjetor 2018. Sipas Zyrës për Djem dhe Burra, ky numër i ulët referimi vjen si pasojë e nivelit të ulët ndërgjegjesimit të gjykatësve për nevojën e përfshirjes së dhunuesve në programe rehabilitimi. Në të njëjtën kohë, nga informacioni që marrim nga ZDB kuptojmë që institucionet të cilat plotësojnë kërkesat për Urdhër Mbrojtje për viktimat e dhunës në familje nuk janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar mbi shërbimin për rehabilitimin e dhunuesve dhe si rrjedhojë, gjatë plotësimit të kërkesës për UM nuk kërkojnë masën për të urdhëruar

rehabilitimin e dhunuesve. Në të njëjtën kohe, viktimat nuk kanë asnjë informacion në lidhje me këtë shërbim.

Zyra vendore e Shërbimit të Provës Shkodër nuk ka një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi me bashkinë Shkodër. Gjithsesi, shërbimi i Provës është gjithnjë i pranishëm në mbledhjet e GTN. Në periudhën Janar-Dhjetor 2018 janë paraqitur pranë ZVSHP-Shkodër 13 raste me veprën penale të dhunës në familje. Në disa raste ZVSHP-Shkodër ka bashkëpunuar me qendrën Zyra për Djem dhe Burra, Shkodër, për ofrimin e shërbimit të këshillimit në lidhje me këto raste. Në raste tjera kemi bashkëpunuar me shërbimin e Qendra komunitare e shendetit mendor.

Gjatë viti 2018, Shërbimi i provës ka referuar 13 raste të dhunuesve, dhe ka referuar pranë Zyrës për Djem dhe Burra 6 raste për tu përfshirë në programin e rehabilitimit psikologjik.

Funksionimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me shërbimin e provës është për t'u vlerësuar për bashkinë e Shkodrës dhe mund të shërbejë si model pozitiv edhe për bashkitë e tjera ku ky bashkëpunim dhe bashkërendim i punës aktualisht mungon. Një aspekt që mund të përmirësohet në përmbushjen e objektivit 3.3 është ndryshimi i mënyrës së mbledhjes së të dhënave dhe publikimi i statistikave nga shërbimi i provës. Disagregimi i të dhënave sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale do të ndihmonte në analizën më të mirë të situatës dhe identifikimin e personave të dënuar për dhunë me bazë gjinore për ofrimin e shërbimeve për rehabilitimin e tyre.

Bashkëpunimi me DVP/seksioni antidhune është shumë i mirë dhe një pikë fortë, kryesisht në zbatimin e vendimeve të gjykatës për identifikim dhe afrimin e dhunuesve pranë shërbimit të ZDB.

Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër

Në bazë të monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Shkodrës për vitin 2018, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër:

- Bashkia e Shkodrës duhet të vijojë të angazhohet në rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
- Trajnim i vazhdueshëm i stafit për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, mbi ndryshimet në legjislacionin shqiptar dhe mënyrat e ofrimit të shërbimeve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore është shumë i rëndësishëm.
- MKR duhet të mblidhet rregullisht çdo muaj, për shkak të numrit të madh të raportimeve për dhunën në familje si dhe të UM dhe UMM të dhëna nga bashkia. Kjo, sepse gjatë vitit 2018

Grupi Teknik Ndërdisciplinat është mbledhur vetëm 3 herë dhe 2 ishin takimet e Komitetit Drejtues të këtij mekanizmi.

- Programi i strehimit për bonuset nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2018 në Bashkinë Shkodër (kategoria e grave të dhunuara nuk ka patur përfitues). Kjo, si pasojë e pezullimit të procesit nga Këshilli Bashkia. Rekomandohet adresimi i kësaj çështje për zgjidhjen e këtij problemi.
- Strehëza e emergjencës është një rast i mirë dhe model, megjithatë, monitorimi tregon se kapacitetet e strehëzës emergjente janë të kufizuara e më tepër burime financiare e njerëzore nevojiten, duke qenë se numri i rasteve për tu strehuar është përtej kapacitetit si dhe buxhetet janë të kufizuara për të mbuluar nevojat ushqimore.
- Rekomandohet një bashkëpunim më i ngushtë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër duke qenë se numri i vendimeve mbetet mjaft i ulët në krahasim më numrin e UMM/UM të pranuar nga gjykata. Sipas informacioneve nga ZDB, ky numër i ulët referimi vjen si pasojë e nivelit të ulët të ndërgjegjesimit të gjykatësve për nevojën e përfshirjes së dhunuesve në programe rehabilitimi.
- Rekomandohen trajnime apo/dhe workshops për institucionet të cilat plotësojnë kërkesat për Urdhër Mbrojtje për viktimat e dhunës në familje, kjo sepse ata nuk janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar mbi shërbimin për rehabilitimin e dhunuesve dhe si rrjedhojë, gjatë plotësimit të kërkesës për UM nuk kërkojnë masën për të urdhëruar rehabilitimin e dhunuesve.
- Rekomandohet gjithashtu edhe informimi i viktimave apo/dhe dhunuesve për shërbimin e rehabilitimit.
- Roli i Koordinatorit Vendor të Dhunës është shumë i rëndësishëm në koordinimin dhe funksionimin e mekanizmit të referimit ndaj është e domosdoshme të rishikohet struktura aktuale e bashkisë për të siguruar burimet e duhura financiare dhe kohore për performimin e detyrave të koordinatorit vendor.
- Referimi i rasteve të dhunuesve nga shërbimi i provës për rehabilitim pranë Zyrës për Djem dhe Burra është gjithashtu një model pozitiv që duhet nxitur edhe në bashki të tjera të vendit ku shërbimet rehabilituese nuk janë të pranishme.
- Organizatat e shoqërisë civile në bashkinë e Shkodrës luajnë një rol të rëndësishëm e pozitiv veçanërisht në ofrimin e shërbimeve si ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje por duhet bërë më tepër për trajtimin e personave të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore.
- MKR Shkodër duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktimat, fëmijët por edhe dhunuesi.
- Për vitin 2018, Objektivi 3.3. është përmirësuar dukshëm në bashkinë Shkodër, por një aspekt që mund të përmirësohet në përmbushjen e tij është ndryshimi i mënyrës së mbledhjes së të dhënave dhe publikimi i statistikave nga shërbimi i provës. Disagregimi i të dhënave sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale do të ndihmonte në analizim më të mirë të situatës dhe identifikimin e personave të dënuar për dhunë me bazë gjinore për ofrimin e shërbimeve për rehabilitimin e tyre.